



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2475/17, për z. Driton Balaj, Prodekan për Çështje Mësimore në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Driton Balaj, Prodekan për Çështje Mësimore në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe njëkohësisht person i autorizuar, në biznesin privat Kompania Konsulente “3 D”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Balaj është njoftuar për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.



Zyrtari i lartë është deklaruar se biznesi nuk zhvillon aktivitet, por vetëm ka mbetë i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, prandaj ka premtuar se brenda afatit ligjor do të ndërmer veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuara po zgjatë, Agjencia i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë, me të cilën i është kërkuar të shmang konfliktin e interesit brenda afatit ligjor, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj konform nenit 18 paragrafi 8 të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI.03-02/4293/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat të cekur më lartë, me qka ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

